**R E P U B L I K A  E  SH Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA KOLONJË**
**DREJTORIA E PYJEVE PARQEVE DHE REKREACIONIT**

**PROJEKT VENDIM**

**NR_____DATË.____.____.2026**

**PER**
**MIRATIMIN E PROGRAMIT TE MASAVE PER PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN E PYJEVE DHE KULLOTAVE NGA ZJARRET PER VITIN 2026**

Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2020 " Për Pyjet" Kreu VI "Trajtimi dhe Sherbimet ndaj Pyjeve", Neni 30 "Mbrojtja e Fondit Pyjor Kombetar" , pika 4 "Per parandalimin e zjarreve ne Fondin Pyjor Kombetar", germat a, b, c, ç, Pika 5 "Per shuarjen e zjarreve ne Pyje", germa a, b, Pika 6 "Për masat e mbrojtjes së pyjeve nga rreziku i zjarrit zbatohen parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin", Pika 7 "Në rast konstatimi të pranisë së sëmundjeve e dëmtuesve ose dëmtimit të pyjeve nga shkaqe të tjera" , germa a, b, c. Ligji nr 8766, dt 05.04.2001 "Per Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimi", V.K.M nr 288 date 27.06.2002 "Per percaktimin dhe marrjen e massave kunder zjarrit dhe shpetimin ne objektet me rendesi ekonomike dhe shteterore", V.K.M nr 290 date 30.04.2004 "Per miratimin e strategjise kombetare te menaxhimit te zjarreve ne pyje dhe kullota", VKM Nr.835, date 03.12.2004 "Per planin kombetar te emergjencat civile", VKM 1080, date 22.12.2010 "Mbi regullat per parandalimin dhe shuarjen e zjarreve ne pyje dhe kullota" dhe ne zbatim te ligjit nr.8927 date 25.07.2002 :Per Prefektin"
Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 " Për Vetqeverisjen Vendore", Këshilli I Bashkisë ne mbledhjen e tij te dates ___ __/_____/2026.

VENDOSI

1. Miratimin e Programit te Masave Per Parandalimin dhe Mbrojtjen e Pyjeve dhe Kullotave nga Zjarret për vitin 2026.

2. Ky projekt-vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefektura.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pyjeve Parqeve dhe Rekreacionit.

**Konceptoi**

**Ing. Ervin ÇUKA**

**Pranoi**

**Petro KRISTO**

**NE MUNGESE DHE ME URDHER**
**NEN/KRYETAR**

**Petro RISTO**

**K R Y E T A R I**

**Erion ISAI**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KOLONJË**
**DREJTORIA E PYJEVE PARQEVE DHE REKREACIONIT**

**Nr 2139 prot.**

**Ersekë më 01.04.2026**

# RELACION

**(Për Miratimin e Programit te Masave Per Parandalimin dhe Mbrojtjen e Pyjeve dhe Kullotave nga Zjarret për vitin 2026)**

Për parandalimin e zjarreve në fondin pyjor kombëtar:

a) strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki/zona të mbrojtura, si dhe pronarët privatë organizojnë sistemin e vrojtim-sinjalizimit duke zbatuar të gjitha detyrimet sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile dhe për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;

b) struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, si dhe pronarët privatë, çdo vit hartojnë planin për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve, për sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar në territorin e tyre, ku përfshihen mjetet në dispozicion, si dhe numri i personave të organizuar në njësitë e posaçme për këtë qëllim, duke koordinuar dhe zbatuar të gjitha përcaktimet e ligjit përkatës për mbrojtjen civile, vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe planin vendor për emergjencat civile;

c) plani për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor kombëtar miratohet nga këshilli bashkiak brenda muajit mars të çdo viti.

Bashkitë koordinojnë këtë plan me detyrimet e ligjit përkatës për mbrojtjen civile, për të siguruar funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në territorin e tyre. Subjektet, që ushtrojnë veprimtari në fondin pyjor kombëtar, detyrohen sipas ligjit përkatës për mbrojtjen civile të garantojnë mbrojtjen nga zjarret në këto sipërfaqe, duke hartuar/përditësuar planet për mbrojtjen e tyre nga zjarret, të harmonizuara me planet e jashtme për emergjencat civile të bashkisë dhe prefekturës, si edhe detyrimin për rregulloret e brendshme të tyre;

ç) struktura përgjegjëse për pyjet në bashki organizon çdo vit fushata informimi, sensibilizimi dhe trajnimi për parandalimin e zjarreve në pyje. Këto fushata organizohen në nivel kombëtar edhe nga ministria dhe agjencia.

Për shuarjen e zjarreve në pyje:

a) njësitë e vetëqeverisjes vendore, komunitetet lokale dhe pronarët privatë ngrenë njësi të posaçme dhe bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me strukturat e tjera shtetërore sipas detyrimeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, përdoruesit e pyjeve përmes përfaqësuesve të tyre lokalë dhe pronarët privatë mbajnë të dhëna statistikore për zjarret në pyjet brenda territoreve të tyre dhe raportojnë pranë agjencisë shtetërore përgjegjëse për pyjet;

b) shpenzimet për shuarjen e zjarreve përballohen nga struktura ose subjekti që ka në pronësi pyllin dhe nga buxheti i shtetit në rastin e një prone me rëndësi kombëtare, historike, kulturore, arkeologjike, ekologjike etj.

Për masat e mbrojtjes së pyjeve nga rreziku i zjarrit zbatohen parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

**Konceptoi**
**Specialisti I Kadastres dhe Kullotave**

**Ing. Ervin ÇUKA**

**Pranoi**
**Drejtori**

**Petro KRISTO**

R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë

**BASHKIA KOLONJË**

**DREJTORIA E PYJEVE PARQEVE DHE REKREACIONIT**

**MIRATOHET**
**KRYETARI**
**ERION ISAI**

**Ersekë më ___.___.2026**

## PROGRAM I MASAVE I PERBASHKET
## PER PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN E PYJEVE DHE KULLOTAVE NGA ZJARRET PER VITIN 2026

Ne zbatim te ligjit nr.57/2020 "Per Pyjet', ligjit Nr.8766 date 05.04.2001 "Per Mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin", V.K.M nr 288 date 27.06.2002 "Per percaktimin dhe marrjen e massave kunder zjarrit dhe shpetimin ne objektet me rendesi ekonomike dhe shteterore", V.K.M nr 290 date 30.04.2004 "Per miratimin e strategjise kombetare te menaxhimit te zjarreve ne pyje dhe kullota". VKM Nr.835, date 03.12.2004 "Per planin kombetar te emergjencat civile", VKM 1080, date 22.12.2010 "Mbi regullat per parandalimin dhe shuarjen e zjarreve ne pyje dhe kullota" dhe ne zbatim te ligjit nr.8927 date 25.07.2002 :Per Prefektin" Per parandalimin dhe shuarjen ne kohe te zjarreve te mundeshme ne pyje dhe kullota, dhe perballimin e situatave emergjente, te merren keto masa organizative, duke u mbeshtetur dhe ne programin e masave te Bashkise Kolonje per parandalimin dhe shuarjen e zjareve ne pyje dhe kullota per vitin 2026.

| Nr. | Objektivi | Pershkrimi i masave qe do te merren ne zberthim te objektivit | Afatet e permbushjes se cdo mase | Percaktimi i treguesve konkrete per vleresimin e realizimit te cdo mase | Kush ngarkohet per realizimin e masave |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | **Koordinimi i punes midis institucioneve per mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri dhe shpetimi** | Ngrihet Shtabi i Qendror i MNZSH-se Kolonje i perbere nga:<br>Drejtoria e Pyjeve Parqeve dhe Rekreacionit prane Bashkise Kolonje<br>Edrion Ajazi Kryetar<br>Ervin Çuka Anetar<br>Rushan Nazarko Anetar<br>Suljot Orhanas Anetar<br>Islam Lico Anetar<br>Kostaq Koroveshi Anetar<br>Fatjon Kasko Anetar<br>Emiljano Islami Anetar<br>Eno Butka Anetar<br>Drejtoria e Pyjeve,Parqeve dhe Rekreacionit prane Bashkise Kolonje | Deri ne 25.05.2026 | • Shtabi i D.P.P.R Kolonje te beje vleresimin e situatave te krijuara, duke marre vendime dhe masa per permiresimin e punes.<br>• Te ushtrohen kontrolle per zbatimin e masave per mbrojtjen nga zjarri, duke hartuar dhe shperndare komunikata periodike per shtyp .<br>• Drejtoria e Pyjeve,Parqeve dhe Rekreacionit ne Bashki dhe zonat e mbrojtura, te hartojne planin e veprimit per menazhimin e zjarreve ne pyje dhe kullota, real dhe i bazuar. | D.P.P.R Bashkia Kolonje<br>D.P.P.R Bashkia Kolonje<br>Zonat e Mbrojtura |
| 2. | **Takim me Administratoret,Drejtoria e Pyjeve ne Bashki dhe Zonat e** | • Do organizohen takime me Administratoret dhe Kryetaret e Fshatrave per masat e mara per mbrojtjen nga zjarri. | Maj 2026 | Ne takim do te diskutohe problemet dhe veprimet per parandalimin dhe menazhimin e zjarreve ne pyje dhe kullota, mundesite reale te bashkepunimit dhe detyrat per cdo institucion. | D.P.P.R Bashkia Kolonje<br>AdZM Kolonje |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **mbrojtura** | | | | |
| 3. | **Ngritja e skuadrave vullnetare te MNZSH-se** | Ne zbatim te legjislacionit ne fuqi, udhezimeve te perbashketa me Ministrine e Brendshme (pushtetin Vendor), ne baze komune dhe fshati, te riorganizohen te gjitha skuadrat vullnetare te gadishmerise per MNZSH-ne ne krye te te cilave te jene kryetaret e fshatrave. | 09 Maj – e vazhdim 2026 | Bashkia Kolonje qe kane marre ne pronesi pyje dhe kullotea, ne bashkepunim me Njesite Administrative, ne cdo fshat/qender te organizojne skuadra vullnetare me banore te afte fizikisht per te marre pjese ne operacionin e shuarjes se zjarrit. | D.P.P.R Bashkia Kolonje<br><br>AdZM Kolonje |
| 4. | **Perdorimi efektiv i burimeve njerezore, materiale dhe financiare** | • Drejtoria e Pyjeve,Parqeve dhe Rekreacionit prane Bashkise do te vere ne dispozicion te gjithe bazen materiale ekzistuese(veglat e punes, fikset, pompat e shpines, mjetet levizese) per shuarjen e zjarreve ne pyje dhe kullota si dhe te hartohet nje skeme lajmerimi dhe komunikimi per mbulimin e gjithe teritorit te rrethit, vecanerisht ne zonat e mbrojtura, Parqet Kombetare dhe grumbujve halore me rrezikshmeri te larte zjarri. | Gjate vitit | • Te percaktohet qarte menyra e komunikimit dhe informimit, e cila te jete ne fuksionim te plote.<br>• Mjetet e punes dhe paisjet e tjera do te vihen ne dispozicion te zonave sipas problematikave.<br>• Mjetet levizese do te jene ne fuksion te shuarjes se zjarreve. | D.P.P.R Bashkia Kolonje<br><br>AdZM Kolonje |
| | | • Ne drejtorinee Pyjeve,Parqeve dhe Rekreacionit prane Bashkise dhe Zonat e mbrojtura te ngrihet dhe te fuksionoje sistemi i njoftim sinjalizimit ne periudhen Maj- 15Tetor, sipas mundesive financiare ekzistuese, te krijohen skuadra vullnetare te vecanta 3-6 veta(te grupuar), per nje veprim te shpejte dhe efektiv, me persona nga zona te banuara prane pyjeve. Zonave te mbrojtura ose ne afersi te tyre.<br>• Ne parqet kombetare , zonat e mbrojtura dhe pyjet me vlera te vecanta turistike, te merren masa suplementare sherbimi kunder zjarrit, sidomos per | 15 Maj- Tetor 2026 | • Ngritjen e nje sistemi efektiv vrojtim sinjalizimi nga Drejtoria e Pyjeve Bashkiake ne bashkepunim me Nj Administrative.<br>• Te zbatohet me korrektesi rregullorja per mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri<br><br>• Te organizohet vrojtim 24 oresh | D.P.P.R Bashkia Kolonje<br><br>AdZM Kolonje |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | ditet e shtuna dhe te diela, duke disiplinuar levizjen e mjeteve dhe vizitoreve<br>• Punetoret qe sherbejne per mirembajtjen e tyre , prioritet per kete periudhe do te kene parandalimin, vrojtimin dhe shuarjen e zjarreve.<br>• Nga cdo sektor te vendoset sherbimi 24 oresh i gadishmerise, i cili do te jape dhe do te marre informacionet e nevojshme ne te gjithe nivelet per cdo rast zjarri, duke percaktuar masat perkatese.<br>• Gjate periudhes Maj- 15 Tetor, cdo dite nga ora 8:00 – 9:00 dhe 15:30 – 16:30, sektoret pyjore do te informojne I.P.P Kolonje me telefon, celular ose mjete te tjera per situaten ne Seksionet e tyre. Per cdo rast zjarri, informimi do te jete i menjehershem dhe i dokumentuar.<br><br>• Per cdo rast zjarri ne pyje dhe kullota, informacioni qe merr i pari njoftimin ne rastin e zjarrit, te njoftojne menjehere DPPR Kolonje, per te bashkerenduar punen me strukturat me te aferta. Per cdo rast nga ana e DPPR do te behet denancimi prane organeve perkatese te policise se Shtetit dhe Prokurorise se rrethit.<br>Nga ana e Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit ne Bashki te evidentohet dhe plotesohet i gjithe dokumentacioni teknik, ne te cilen te perfshihen te gjithe elementet dhe faza e zhvillimit te nderhyrjes. | Mars-15Tetor 2026<br><br>Mars-15 Tetor 2026<br><br>Vazhdim | i ZM dhe parqeve kombetare<br>• Investimet qe do akordohen te planifikohen ne keto zona.<br>• Informimi te behet nga persone te autorizuar nga titullari. Njoftimi ne media te behet ne kohen e duhur, nga persona te autorizuar, me qellim dhenjen e informacionit te plote, per te mos shkaktuar konfuzion.<br><br>Te sigurohet pjesmarja e te gjithe strukturave i cili eshte detyrim ligjor.<br><br>Drejtoria e Pyjeve ne Bashki, te plotesoje dokumentacionin, ku perfshihen: evidencat operative, situacioni i shpenzimeve per shuarje, harta e siperfaqes se pershkruar nga zjarri, raporti i vleresimit te sip te djegur, shkaqet e renjes se zjarrit, demi ekonomik i shkaktuar, fondet e nevojshme per rehabilitim. | D.P.P.R Bashkia Kolonje<br>AdZM Kolonje<br><br>D.P.P.R Bashkia Kolonje<br>AdZM Kolonje |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | • Drejtorite e Pyjeve,Parqeve dhe Rekreacionit ne Bashkiak te identifikoje dhe te hedhe ne harte, depot me municion ushtarak, zonat e minuara ose qe kane rezikshmeri per shperthimin e municioneve luftarake, duke ja bashkengjitur planit te veprimit. | Cdo rast zjarri<br><br>Deri ne 30 Qershor 2026 | • Hartografimi i zonave te jete pjese e planit vjetor te menazhimit te zjarreve ne Agjensine e Pyjeve dhe Kullotave. | |
| 5. | **Informimi i publikut** | • DPPR Kolonje nepermjet mjeteve te informimit publik, medjas se shkruar dhe asaj elektronike lokale do organizoje spote publicitare per sensibilizimin e opinjonit publik per demet e shkaktuara nga zjarret ne pyje dhe nevojen per bashkepunimin e mbeshtetje ne procesin e shuarjes se tyre. | Gjate vitit 2026 | • Te sigurohen dhe shperndahen flete palosje qe shoqeron fenomenin e zjarreve ne pyje.<br>• Te kontaktohet me TV lokale per organizimin e emisioneve televizive me tema per mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave. | D.P.P.R Bashkia Kolonje<br><br>AdZM Kolonje |
| 6. | **Kontrolle operative** | • Per ndjekjen hap pas hapi te zbatimit te ketij programi, ngarkohen sektori DPPR Kolonje, Njesite Administrative,AdZM. Per te gjitha rastet e renjes se zjarreve ne pyje dhe kullota, te behen analiza te vecanta, duke marre masat e nevojshme. | Vazhdimish | • Te meren masa parandaluese ne kohen e duhur per rritjen e efektivitetit te punes ne rastet e zjarreve. | D.P.P.R Bashkia Kolonje<br><br>AdZM Kolonje |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 7. | **Vprimet konkrete qe ndermeren per shuarjen e zjarreve ne pyje** | • Vrojtues/sinjalizuesit e sektoreve pyjore sipas zonave njoftojne menjehere sipas skemes se informimit te percaktuar si me pare.<br>• Srukturat operative te nderhyrjes dhe skuadrat vullnetare te komunitetit, me marjen e njoftimit, organizojne punen per shuarjen e zjarrit.<br>• Ne rast nevoje kerkohet ndihme nga strukturat e tjera te specializuara. | Vazhdimish | • Sherbimi pyjor te ngreje skuadrat ne bashkepunim me NJ Administrative per nderhyrje direkte per luftimin e zjarrit. | D.P.P.R Bashkia Kolonje<br><br>AdZM Kolonje |
| 8. | **Bashkepunim institucional** | • Shtabi i MNZSH-se te mblidhet cdo muaj dhe menjehere ne cdo rast emergjent. Ne rastete nevojshme do kerkohet bashkepunimi me strukturat e tjera.<br>• Ne rast nevoje te bashkepunohet me zonat kufitare shteterore fqinje dhe kur eshte nevoja te kerkohet mbeshtetje prane prefektures per ndihme. | Cdo muaj dhe menjehere per cdo rast emergjent. | • Te zbatohen vendimet e mara nga shtabi.<br>• Ne rast nevoje te kerkohet ndihme dhe mbeshtetje nga drejtoria e Emergjencave Civile dhe Mbrojtjes. | D.P.P.R Bashkia Kolonje<br><br>AdZM Kolonje |
| 9. | **Trajnime** | • Ne bashkepunim me strukturat e specializuar per mbrojtjen nga zjarri, te organizohen seminare trainuese per personelin pyjor dhe te skuadrave vullnetare te mbrojtjes nga zjarri. | Deri ne 30 Maj 2026 | • Te organizohen seminare trajnimi dhe njohje, per tekniken e shuarjes se zjarreve ne pyje dhe kullota dhe masat e sigurimit per jeten, ne komuna dhe fshatra. | D.P.P.R Bashkia Kolonje<br><br>AdZM Kolonje |

**Konceptoi**

**Ing. Edrion AJAZI**

**Ing. Ervin ÇUKA**

**Pranoi**

**Petro KRISTO**